

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegjii i përberë nga gjyqtaret: Enver Peci, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, si procesmbajtës, ne kontestin administrativ sipas padisë se përbashkët te paditësve, R. L. Komuna e Skenderajt, T. M., nga Mitrovica, Sh.B.,nga Komuna e Pajës, B. G. nga Komuna e Rahovecit, kundër te paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil te Republikës se Kosovës ne Prishtine, për shkake te anulimit te vendimit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor te paditësve, të paraqitur kundër aktgjykimit te Gjykatës se Apelit te Kosovës, AA.nr.45/2016 te datës 02.03.2016, si dhe aktgjykimit te Gjykatës Themelore ne Prishtine Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.853/2014 te datës 14.12.2015, ne seancën e kolegjii te mbajtur me 23.05.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e paditësve R. L. , T. M., Sh. B., dhe B.G., për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor e parashtruar kundër aktgjykimit te Gjykatës se Apelit te Kosovës, AA.nr. 45/2016 te datës 02.03.2016.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e atakuar te Gjykatës se Apelit te Kosovës, AA.nr. 45/2016 te datës 02.03.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësve B. G., R. L., T. M. dhe Sh. B., ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Prishtine-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.853/2014, i datës 14.12.2015.

Paditësit kësaj gjykate përmes përfaqësuesit te autorizuar avokatit B. J., i kane parashtrua kërkesë për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësorë, me te cilën ne tersi kontestojnë ligjshmërinë e aktgjykimeve te shkalles se pare dhe te dyte për shkake te shkeljes te se drejtës materiale me propozim qe te aprovohet si e bazuar kërkesa

për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, AA.nr. 45/2016 të datës 02.03.2016, dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative A.nr. 853/2014, i datës 14.12.2015 të ndryshohen ashtu që Gjykata Supreme të shpall vendimin nr. 123/2014 akt absolutisht të pa vlefshëm, ose çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjyqimit të atakuar, kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Kërkese është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Çështje Administrative AA.nr. 45/2016 të datës 02.03.2016, është refuzuar si pa bazuar ankesa e paditësve; B. G., R. L., T.M., dhe Sh. B., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr.853/2014, i datës 14.12.2015 është vërtetuar, me të cilën është refuzuar kërkesë-padia e paditësve me të cilën kanë kërkuar që të aprovohet si e bazuar padia dhe të anulohet akti administrativ i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nr A/02/126/2014 të datës 02.05.2014, si e pa bazuar.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjyqimit të kontestuar, shkresat e lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se gjykata e shkallës së dytë drejt ka vepruar kur ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e palës së paditur dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tersi e aprovon edhe kjo gjykatë, nga se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshi me shkelje siç pretendojnë paditësit në kërkesë.

Në këtë çështje administrative paditësit në kërkesë për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimeve gjyqësore pretendojnë se gjykatat e shkallës me të ulet me aktgjykimet e tyre kanë shkel të drejtën materiale në dem të tyre dhe at të dispozitave të

Ligjit për Shërbyes Civil, Ligji për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Ligji i Punës nga se konsiderojnë se iu takon pagesa shtese për punën e kujdestarisë, punën e natës, jashtë orarit të punës dhe punët gjate vikendeve dhe festave zyrtare. Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur lidhur me këto pretendime dhe duke vlerësuar ne kontekst të gjithanshëm të kësaj çështjeje administrative konstatoj si vijon:

Ne baze të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjykata në konfliktet administrative vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative. Po ashtu në baze të nenit 13 të LKA përshihet se konflikti administrativ në parim mundet të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerre në procedurën administrative në shkallen e dytë. Nga shkresat e lendes para se të fillojë ky konflikt administrativ me padinë e re sipas vendimit të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës (në tekstin e mëtejme KSK) nr. 8/12 i datës 16.01.2012 u konstatua se i njëjti është nxjerr jashtë afatit ligjor pasi që ankuesit –tani paditësit kanë paraqit ankesë me date 29.11.2011 ndërsa vendimi nga komisioni është nxjerr me date 16.01.2012, jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 7 të Rregullores nr.02/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin A.nr.546/12 të datës 10.03.2014, aprovon padinë e paditësve dhe anulon vendimin nr. 02/05/2012 të datës 03.04.2012 të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë (në tekstin e mëtejme KPMSHCK), duke vërtetuar se organi i paditur nuk është dashur që gjate vendimmarrjes të lëshohet në meritat e vendimit nr. 08/12 të datës 16.01.2012, pasi që akti i tillë administrativ është konsideruar absolutisht i pavlefshëm pasi që është nxjerr në kundërshtim me nenin 92 pika(d) të Ligjit për Procedurën Administrative. Kjo gjykate me këtë aktgjykim në vërejtjet e saja e ka obliguar organin e paditur KPMSHCK që të rivendosë lidhur me këtë kontest administrativ.

E paditura duke vepruar sipas aktgjykimit të sipërpërmendur me vendimin A/02/126/2014 me date 02.05.2014, vendimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës nr. 08/12 të datës 16.01.2012 e shpall akt administrativ absolutisht të pavlefshëm dhe obligon Sekretariatit e KSK përkatësisht komisionin e këtij këshilli për rishqyrtimin e ankesës nr. 271/2011 të datës 29.11.2011, me ç'rast komisioni në fjalë duke vepruar sipas këtij vendimi të paditurës me vendimin nr.123/2014 të datës 19.05.2014 e refuzon ankesën e paditësve lidhur me mos pagesën e

kujdestarive dhe punës jashtë orarit. Paditësit me date 06 qershor 2014 i drejtohen gjykatës me padi duke filluar konfliktin administrativ për anulimin e vendimit A/02/126/2014 te datës 02.05.2014 te KPMSHCK duke anashkaluar vendimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave te Këshillit te Sigurisë se Kosovës, nr.123/2014 te datës 19.05.2014 edhe pse ne baze te Rregullores nr.02/2011 për Procedurat e Zgjedhjes se Kontesteve dhe Ankesave ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil te Kosovës neni 11 parasheh te drejtën e ankesës kundër këtyre vendimeve ne KPMSHCK, brenda afatit prej 30 ditësh.

Nga te cekurat e mësipërme, Gjykata Supreme gjeti se ne rastin konkret nuk kemi akt administrativ te nxjerre ne procedurën administrative ne shkallen dyte, andaj kjo gjykatë nuk u lëshua ne shkeljet eventuale te drejtës materiale siç pretendojnë paditësit ne kërkesën e tyre për shkake se vendimi i kontestuar i te paditurës nuk lëshohet ne te drejtën e paditësve ne kërkesat e tyre pasi qe aktin administrativ te shkalles se pare e shpalle absolutisht te pa vlefshëm dhe çështjen e kthen ne rivendosje te ky organ administrativ ne fazën fillestare për rishqyrtim. Sipas vlerësimit te kësaj gjykate, aktgjykimi i atakuar i shkalles se dyte është i qarte dhe i kuptueshme, ne arsyetimin e te njëjtit janë dhënë arsya te nevojshëm mbi faktet vendimtare te cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Nga si u tha me sipër, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVES

Me 23 maj 2016, ARJ.nr.18/2016

Procesmbajtësi,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,  
Enver Peci